



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1391/7 prot.

Datë 28.07.2025

V E N D I M
Nr. 964/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-48784-05-23-2025, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me fond limit 54,161,860.31 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.06.2025, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK me NIPT K91413010N, me adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
Adresa: Rruga “5 Maji” , Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.05.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-48784-05-23-2025, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me fond limit 54,161,860.31 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.06.2025, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

II.2. Në datën 30.05.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5353 dhe me nr. 1391/2025 prot., datë 02.06.2025, i operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 1990/4 prot., datë 10.06.2025, protokolluar me tonën me nr.1391/1 prot., datë 12.06.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur refuzimin e saj.

II.5. Me shkresën nr. 1391/2 prot., datë 02.07.2025, KPP ju drejtuar autoritetit kontraktor me kërkesën si vijon: “[...] Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda ditës së nesërme nga marrja dijeni e kësaj shkrese, informacion lidhur me përllogaritjen e fondit limit (të preventivit me çmime), përllogaritjen analitike për fuqinë punëtore dhe përllogaritjen analitike për mjetet e kërkuara, mbi bazën e preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve, të njehsuara me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit tuaj kontraktor”.

II.6. Me shkresën nr.2401/1 prot., datë 07.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1391/3 prot., datë 09.07.2025, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të KPP informacionin e kërkuar më sipër.

II.7. Me shkresën nr.2938 prot., datë 22.07.2025, me objekt “Kërkesë”,protokolluar me tonën me nr. 1391/4 prot., datë 24.07.2025, autoriteti kontraktor i është drejtuar KPP me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK , lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK për kategoritë e licencës NP - 3 B dhe NS - 4 B, për të cilat pretendon se kërkesa për kategori “B” për shërbime mirëmbajtje është e pajustificuar, e për rrjedhojë kërkon modifikimin e këtij kriteri, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se.

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.1 , të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.1.1 *Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

Operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Licenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- *NP - 3 B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale;*
- *NS - 4 B Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to etj.*

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Neni 41, pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.1.5. Në kreun I, pika 1 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të

subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, përcaktohet se: “*Licencë profesionale*” është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t’u pajisur me një të tillë.

Ndërsa në lidhjen nr. 2, 3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar përcaktohet:

LIDHJA 2

TABELA

Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit në ndërtim

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- | | |
|-----------------------|---|
| <i>N.P – 1</i> | <i>Punime gjërmimi në tokë.</i> |
| <i>N.P – 2</i> | <i>Ndërtime civile dhe industriale.</i> |
| <i>N.P – 3</i> | <i>Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.</i> |
| <i>N.P – 4</i> | <i>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.</i> |
| <i>N.P – 5</i> | <i>Punime nëntokësore, ura e vepra arti.</i> |
| <i>N.P – 6</i> | <i>Diga dhe tunele hidroteknike.</i> |
| <i>N.P - 7</i> | <i>Ujsgjellësa, gazsgjellësa, vajsgjellësa, vepra kullimi e vaditje.</i> |
| <i>N.P – 8</i> | <i>Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.</i> |
| <i>N.P - 9</i> | <i>Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.</i> |
| <i>N.P - 10</i> | <i>Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.</i> |
| <i>N.P – 11</i> | <i>Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.</i> |
| <i>N.P – 12</i> | <i>Punime të inxhinierisë së mjedisit</i> |

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- | | |
|----------------|---|
| <i>N.S – 1</i> | <i>Punime për prishjen e ndërtimeve.</i> |
| <i>N.S- 2</i> | <i>Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.</i> |

N.S- 3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

N.S.- 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

N.S - 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

N.S – 6 Sinjalistika rrugore jondriçuese.

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore.

N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri. N.S – 9 Punime strukturore speciale.

N.S – 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.

N.S – 11 Punime mbi shina dhe traversa.

N.S - 12 Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

N.S – 14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

N.S- 15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.

N.S – 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

N.S – 17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.

N.S – 18 Punime topogjeodezike.

N.S.- 19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.

N.S.- 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI
A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë
F	401 – 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

III.1.6. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat 2 e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “.....Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.....” Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e ankimesit për kategoritë e licencës NP - 3 B dhe NS - 4 B, për të cilat pretendon se kërkesa për kategori “B” për shërbime mirëmbajtje është e pajustificuar, KPP në mungesë të një preventivi me çmime të autoriteti kontraktor ju drejtua këtij të fundit me kërkesën për informacion për vënien në dispozicion të preventivit me çmime për të parë nëse kërkesa për këto kategori licence së bashku me nivelin ishte e justifikuar apo jo. Me shkresën nr.2401/1 prot., datë 07.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1391/3 prot., datë 09.07.2025,

autoriteti kontraktor ndër të tjera ka vënë në dispozicion të KPP informacionin lidhur me përlllogaritjen e fondit limit (të preventivit me çmime).

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* i ndryshuar, konkretisht në lidhjen 4 të tij, bëhet klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi, ku niveli “B” i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi është 21-50 milion lekë. KPP shqyrtoi preventivin me çmime të dërguar nga autoriteti kontraktor përmes shkresës me nr.2401/1 prot. datë 07.07.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor për preventimin me çmime e gjen të justifikuar kërkesën e autoritetit kontraktor për pikën NS-4 B dhe të pa justifikuar kërkesën e autoritetit kontraktor për NP - 3 B. Vlera për zërat e preventivit, që bëjnë pjesë në kategorinë e punimeve për N.P-3 *“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”*, nuk e arrin vlerën ndërmjet 21-50 milion lekë që të justifikojë kërkesën për nivelin “B” . Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart arsyetuar, referuar kategorisë së punimeve N.P-3, zërave të preventivit që bëjnë pjesë në këtë kategori dhe vlerave në lekë të këtyre zërave sipas preventivit me çmime, KPP e gjen në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* kërkesën për licencë N.P-3 B, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për rishikim e saj në përputhje me zërat e punimeve që bëjnë pjesë në këtë kategori dhe vlerat përkatëse të tyre.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për ndryshimin e kategorisë “NS-4 B, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi vlera për zërat e preventivit, që bëjnë pjesë në kategorinë e punimeve për N.S-4 *“Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese”*, e arrin vlerën ndërmjet 21-50 milion lekë duke justifikuar kërkesën për nivelin “B” .

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK për kriterin 2.3.3 të dokumenteve të tenderit, për të cilin pretendon se kërkesa për 120 punonjes është e ekzagjeruar dhe jo e lidhur me nevojën reale të punës, duke kërkuar uljen e numrit të punonjësve të kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 , të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 120 (njëqind e njet) punonjësve për periudhën Shkurt 2025 – Prill 2025 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;*

- *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;*
- *Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2025 – Prill 2025.*

Shënim: *Kjo kërkesë (2.3.3) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.5. Neni 41, pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41 stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.2.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike, lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar:

Argumentimi: Për sa i përket përcaktimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës jemi bazuar tek zbërthimi i zërave preventivit, kohëzgjatja e kontratës dhe përcaktimi i orëve të punës të përllogaritura në bazë të parashikimeve ligjore në nenin 19 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” dhe çmimet e Manualit të Punimeve të Ndërtimit i miratuar nga Këshilli Ministrave me Vendimin Nr.629 datë 15.07.2015 (i ndryshuar), dhe analizave teknike për punimet e ndërtimit...

Ore pune ne total per kryerjen e sherbimit (referuar normative sipas Manualit Teknik) 75,443
Dite pune 8 orarshe ne total per kryerjen e sherbimit ore pune Total/8 ore ne dite = 9,430

Periudha në ditë e kryerjes se sherbimit eshte 3 muaj 26 dite pune ne muaj*3 muaj = 78

Numri i fuqise punetore per kryerjen e sherbimit per 78 dite 9 430 Dite pune total /78dite = 121

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast,

autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, për uljen e numrit të punonjësve të kërkuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë për një punësim mesatar prej prej 120 punonjës për periudhën Shkurt 2025-Prill 2025 dhe në vazhdim është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, zërave të preventivit si dhe kohëzgjatjes së punimeve, si dhe argumentimit të bërë në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka arritur të justifikojë teknikisht dhe ligjërisht kërkesën për një punësim mesatar prej prej 120 punonjës për periudhën Shkurt 2025-Prill 2025 dhe në vazhdim. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon stafin e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK për kriterin 2.3.4 dhe kriterin 2.3.5 të dokumenteve të tenderit, për të cilët pretendon **për kriterin 2.3.4** : *“Ne kete rast, arkitekti nuk kontribuon ne ekzekutimin teknik te sherbimit te kerkuar, prandaj kjo kerkese eshte e panevojshme, eshte jashte objektit te kesaj procedure prokurimi dhe eshte kufizues ndaj operatoreve ekonomike te interesuar per te marre pjese ne kete procedure dhe **kerkojme qe te hiqet**” dhe për kriterin 2.3.5. “Kjo kerkese nuk eshte objektive dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe lidhjen e drejtperdrejte me objektin e prokurimit, dhe si e tille **kerkojme qe te hiqet si kriter**”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4 e 2.3.5 , të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.4 Operatorët ekonomikë ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për muajin e fundit, dhe në vazhdim, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi,
- 1 (një) Arkitekt.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.4) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin staf mbështetës, dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për muajin e fundit dhe në vazhdim, ose me kontrate bashkepunimi si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Materialelesh

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.5) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.3.2. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike, lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar:

(2.3.4.) Argumentimi: Kërkesa për inxhinierin dhe arkitektin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet

e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e shërbimeve në përputhje me zërat e pasqyruara në preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e shërbimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen shërbimet. Është kërkuar arkitekt për faktin që natyra e shërbimeve, për zërat kryesore të preventivit që është lyerja e objekteve, sidomos fasadave të jashtme të objekteve arsimore, prandaj rezulton se duhet patjetër që përzgjedhja dhe kombinimi i ngjyrave në sipërfaqe relativisht të mëdha të realizohet nga një specialist i kualifikuar.

(2.3.5.)Argumentimi: *Kërkesa për inxhinierin e materialeve në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Inxhinieri i materialeve është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen shërbimet.*

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të*

tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.3.5. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.6. Neni 41, pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.3.7.Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij *1 (nje) Arkitekt dhe 1 (nje) Inxhinier Materialesh* Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj, si dhe zërave të preventivit kërkesat e autoritetit kontraktor për *1 (nje) Arkitekt dhe 1 (nje) Inxhinier Materialesh* nuk i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk është në përputhje me çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e *dy specialistëve të sipërpërmendur* nuk është në përputhje me zërat e parashikuara në preventiv. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, si dhe zërave të preventivit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të modifikojë kriteret e kualifikimit duke hequr kërkesën lidhur me këto dy specialitete, si kërkesë e ekzagjeruar që ndikon në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë

III.4.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Pastrime Silvio” SHPK për kriterin 2.3.6, 2.3.7 dhe kriterin 2.3.8 të dokumenteve të tenderit, për të cilët pretendon **për kriterin 2.3.6** : *“Lista e gjate me bojaxhinj, suvatures, elektrike, muratore per sisteme etj., eshte disproporcionale per nje kontrate qe ka per objekt sherbimin e mirembajtjes dhe lyerjes ne nje*

sasi dhe kompleksitet te caktuar. **Kerkesa qe te gjithë keta punonjes te jene te regjistruar ne listepagesa, me kontrata pune dhe te kene certifikata te licencuara nga institucionet shteterore, krijon barriera te panevojshme per operatorët ekonomike**, sidomos ata qe punojne ne forma fleksibile ose me kontrata bashkepunimi. Per me teper, kriteret shkojne pertej objektit te kontrates, duke detyruar operatorët te paraqesin staf shume specifik, edhe pse puna ka natyre mirembajtjeje e thjeshte. AK nuk ka analizuar mjaftueshem nese keto kerkesa jane ne harmoni me natyren e kontrates. Nuk ka marre ne konsiderate fleksibilitetin e tregut te punes dhe menytrat alternative te angazhimit te stafit teknik qe jane te ligjshme. **Per kete arsye, kerkojme modifikimin e ketij kriteri.**”, për kriterin 2.3.7. “Ligji nr. 10237/2010 “Per sigurimin ne pune” kerkon qe ne cdo vend pune te jete caktuar nje pergjegjes per sigurine, dhe jo me shume, pervec rasteve me disa kantiere njekohesisht. Ne kete rast kemi nje kontrate sherbimi ne objekte arsimore, dhe jo nje projekt masiv ndertimi. Nje pergjegjes eshte i mjaftueshem. **Kerkesa per 2 pergjegjes bie ndesh me ligjin dhe VKM-ne per prokurimin publik dhe eshte e pajustifikuar ligjerisht dhe teknikisht, dhe per kete arsye kerkojme modifikimin e ketij kriteri.**”, dhe për kriterin 2.3.8. “Kerkesa per 12 punonjes me certifikate per lartesi nuk provohet, pasi nuk argumentohet nevoja per kaq shume punonjes njekohesisht me certifikate per punime ne lartesi. **Nuk jepet liste objektesh qe e kerkojne kete.** Ne DST nuk percaktohet asnje vleresim risku, lartesi objektive, apo kohezgjatje te punimeve ne lartesi. Si me teper sqaruar, per sa kohe qe do te punohet mbi planifikime mujore, nuk do te jete e nevojshme qe nje numer kaq i madh punonjesish te jene te gatshe ne te njejten kohe. Per kete arsye, **kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe zvogelimin e numrit te punonjesve per punime ne lartesi.**”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.6, 2.3.7 e 2.3.8, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesën e subjektit për muajin e fundit dhe në vazhdim, minimumi:

- 21 (njëzet e nje) punonjës bojaxhi
- 5 (pese) punonjës suvatues
- 5 (pese) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës specialist për sisteme te thata
- 6 (gjashte) punonjës për veshje fasade (sistemi kapot)

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional) lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.6) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 2 (dy) punonjës të cilët të jenë të pajisur me çertifikatën e trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për muajin e fundit dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/liçensuara.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.7) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 12 (dymbëdhjetë) punonjës të cilët të jenë të pajisur me çertifikatën e trajnimit “Për punimet në lartësi/montim skelerie” ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për muajin e fundit dhe në vazhdim. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/ liçensuara.

Shënim: Kjo kërkesë (2.3.8) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.4.2. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike, lidhur me këto kriterë autoriteti kontraktor ka argumentuar: **2.3.6 Argumentimi:** *Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar nga institucione të arsimit profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i prevetivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

a) 21 (njëzet e nje) punonjës bojaxhinj të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 3(tre) ose 4 (katër) bojaxhinj të kualifikuar duhet të jenë të pranishëm në çdo objekt.

b) 5 (pese) punonjës suvatues të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme sipas grafikut të parashikuar të shërbimeve, është gjykuar që të paktën 1 (një) suvatues i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt.

c) 5 (pese) punonjës teknik ndërtimi të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) teknik ndërtimi i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt ku është i nevojshëm.

d) 2 (dy) punonjës specialist për sisteme te thata te kualifikuar jane vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të 9 ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 2 (dy) specialist për sisteme te thata te kualifikuar duhet të jenë pjesë e stafit teknik për realizimin e kontratës pasi natyra e punës kërkon aftësi profesionale të kualifikuara.

e) 6 (gjashte) punonjës për veshje fasade (sistemi kapot) të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 6 (gjashte) specialist për sisteme të thata të kualifikuar duhet të jenë pjesë e stafit teknik për realizimin e kontratës pasi natyra e punës kërkon aftësi profesionale të kualifikuara.

2.3.7. Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shendetin në punë”, i cili përcakton se..... Neni 7.....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit....1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion...., dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo 10 sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.8. Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shendetin në punë”, i cili përcakton se..... Neni 7.....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit...1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.....2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni:.....c) punëmarrësit/punëmarrësve i/u sigurohen nga punëdhënësi mjetet dhe trajnimi i nevojshëm për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj....., dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si “Për punimet në lartësi” ose ekuivalente nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të

shfaqet gjatë punimeve në lartësi dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Duke iu referuar preventivit të pasqyruar në DST parashikohen ngritje skelash dhe punime në to në lartësi deri 8 m me një sipërfaqe të konsiderueshme

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi uljen e numrit të specialistëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.6 e më konkretisht të “ 21 (njëzet e nje) punonjës bojaxhi, 5 (pese) punonjës suvatures, 5 (pese) punonjës teknik ndërtimi, 2 (dy) punonjës specialist për sisteme te thata, 6 (gjashte) punonjës për veshje fasade (sistemi kapot) ”, referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt-prokurimi, sasive dhe karakteristikave të shërbimeve të parashikuara në preventiv, Komisioni gjykon se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor është kufizuese, si dhe jo në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës, pasi objekti i prokurimit është mirëmbajtje e objekteve specifike. Nisur nga parashtrimet e operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me pretendimet për ndryshimin e numrit të punonjësve të parashikuar në pikën 2.3.6 KPP, gjykon se është ky është një kriter i cili e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi si dhe ul konkurrencën, dhe jo në proporcion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë duke mos e kufizuar atë, lidhur me numrin e punonjësve të kërkuar, duke vendosur ata punonjës, të cilët janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, i cili kërkon që këta punonjës të mos jenë të regjistruar në listpagesa dhe të mos jenë të certifikuar nga institucionet shtetërore Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik lidhur me listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit e në vazhdim si dhe të certifikuar nga institucionet shtetërore, është një kërkesë në përputhje me objektin dhe kohëzgjatjen e kontratës. Fakti që punonjësit të figurojnë të deklaruar në listëpagesë për muajin e fundit e në vijim përbën garanci, se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohej në kohë dhe me sukses. Po ashtu, certifikimi i punonjësve është një prej elementeve kyç për sigurinë dhe cilësinë e shërbimit që ofrohet gjatë realizimit të kontratës, dhe është një garanci e fortë për përmbushjen e standardeve dhe kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Certifikimi i punonjësve konfirmon që ata kanë përfunduar trajnimet dhe kurset e nevojshme dhe i shërben autoritetit kontraktor për të përmbushur në kohë

dhe me cilësi kontratën. Në këtë kuptim KPP gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik lidhur me këtë pikë nuk qëndrojnë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për uljen e numrit të punonjësve të pajisur me certifikatën e trajnimit si Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shenderit në punë”, si dhe uljen e numrit të punonjësve të pajisur me certifikatat e trajnimit “Për punimet në lartësi/montim skelerie”, Komisioni gjykon se të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa për punonjës të certifikuar për sigurinë dhe mbrojtjen e shenderit në punë dhe punonjësve të pajisur me certifikatat e trajnimit “Për punimet në lartësi/montim skelerie”, i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Por numri i kërkuar lidhur me këta punonjës, nuk është proporcional me objektin e prokurimit dhe jo në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat dhe shërbimet që do të kryhen, por këto kërkesa duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe me legjislacion për prokurimin publik dhe legjislacion sektorial. Në këtë kuadër, KPP gjykon, se për sa kohë kërkesat e mësipërme i shërbejnë qëllimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e qëllimit, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve të kërkuar lidhur me këto dy specialitete.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për uljen e numrit të punonjësve në lartësi për arsye edhe të mospublikimit të listës së objekteve që e kërkojnë këtë specialitet Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së publikimit objekt ankimi nuk ka publikuar listën e objekteve ndërtimore që do të mirëmbahen. Në mbështetje të parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme, të përcaktuara në nenin 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka detyrimin ligjor të sigurojë publikimin dhe vënien në dispozicion të informacionit të nevojshëm për përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë. Në rastin konkret, lista e objekteve që do të mirëmbahen përbën një element thelbësor të dokumentacionit të procedurës, pasi, kjo listë përcakton qartësisht përmasat dhe kompleksitetin e shërbimit të kërkuar, duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerësimin e nevojave për burime njerëzore, pajisje, si dhe kostot financiare që OE-të duhet të marrin parasysh në përgatitjen e ofertës së tyre. Gjithashtu, njohja paraprake me objektet që do të mirëmbahen u jep mundësi operatorëve ekonomikë të vlerësojnë me saktësi numrin dhe llojin e punonjësve të nevojshëm, përfshirë ata që do të punojnë në lartësi, të cilët kërkojnë trajnime të posaçme dhe masa shtesë sigurie. Mungesa e kësaj liste krijon pasiguri dhe i vendos operatorët ekonomikë ofertues në pozitë të pabarabartë, duke cënuar parimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues. Për më tepër, publikimi i listës së objekteve nuk përbën informacion konfidencial sipas kuptimit të nenit 16 të Ligjit Nr. 162/2020,

pasi ka të bëjë me specifikimet teknike të kontratës dhe jo me të dhëna të ndjeshme të ndonjë pale të tretë. Përkundrazi, transparenca në këtë rast rrit integritetin e procedurës dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit. Në këto kushte, KPP vlerëson se për të garantuar një procedurë konkurruese, të drejtë dhe transparente, Autoriteti Kontraktues duhet të marrë masa dhe të publikojë listën e objekteve që do të mirëmbahen.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK për kriterin 2.3.9, 2.3.10 dhe kriterin 2.3.11 të dokumenteve të tenderit, për të cilët pretendon **heqjen e këtyre kritereve**, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.9, 2.3.10 dhe kriterin 2.3.11, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.9 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për të gjithë materialet të cilat do të përdoren për zbatimin e kontratës të cilat janë të pasqyruara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve teknike (publikuar në SPE). Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbesite kjo nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

2.3.10 *Ne mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë për të gjithë materialet të cilat do të përdoren për zbatimin e kontratës të cilat janë të pasqyruara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve teknike (publikuar në SPE), katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë ose skemat teknike të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skema teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse materialet të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

2.3.11 *Me qëllim vërtetimin e përmbushjes së standarteve teknike të kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë/Çertifikatë Konfirmimit CE ose Ecolabel ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar për materialet të cilat do të përdoren në shërbimet e mirëmbajtjes të parashikuara sipas preventivit të publikuar, për të cilët janë kërkuar standarte teknike kombëtare apo ndërkombëtare të miratuara, të specifikuara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike (publikuar në SPE), me qëllim vërtetimin e përmbushjes standarteve teknike të kërkuara.*

III.5.2.Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.5.3. Në pikën 2 të nenit 41të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

III.5.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret lidhur me kërkesat e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të paraqesë *Autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për te gjithë materialet te cilat do te perdoren per zbatimin e kontrates te cilat jane te pasqyruara ne Shtojcen 6 Formulari i Specifikimeve teknike (publikuar ne SPE). Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar*

dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP konstaton se objekti i kontratës lidhet me shërbime mirëmbajtjeje, të cilat përfshijnë përdorimin e mallrave për realizimin e shërbimit. Në këtë kontekst, mallrat janë pjesë përbërëse e shërbimit dhe jo një qëllim më vete i kontratës. Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar mund të konsiderohet kufizuese, për sa kohë mallrat nuk janë produkte të veçanta ose të ndjeshme për të cilat është e domosdoshme një zinxhir furnizimi i certifikuar për çështje sigurie ose garancie AK nuk ka parashtruar ndonjë arsyetim teknik apo ligjor për këtë kusht, siç kërkohet nga neni 77, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon se çdo kërkesë specifike në kriteret e kualifikimit duhet të jetë e justifikuar dhe proporcionale me objektin dhe vlerën e kontratës. Komisioni vlerëson se kërkesa për paraqitjen e katalogut/fragmenteve të katalogut mjafton për të vlerësuar përputhshmërinë teknike. Në dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues ka parashikuar në Shtojcën 5 specifikimet teknike të mallrave që kërkohen si pjesë e shërbimit të mirëmbajtjes, dhe ka kërkuar nga OE-të katalog ose fragmente katalogu, për të vlerësuar përputhshmërinë me këto specifikime. Kërkesa për katalog është një kërkesë e mjaftueshme dhe objektive për verifikimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së mallrave me specifikimet e kërkuara. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson së kërkimi edhe i autorizimit nga prodhuesi apo distributori përbën një kufizim të panevojshëm të konkurrencës, i cili nuk jep garanci shtesë mbi cilësinë përtej asaj që ofrohet nga katalogu teknik dhe përjashton operatorë që ofrojnë mallra të përputhshme, por nuk janë pjesë e rrjetit zyrtar të shpërndarjes së prodhuesit, edhe pse mallrat plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër arsyetuar KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesat e autoritetit kontraktor për autorizim prodhuesi/distributori, nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Kriteri i sipërpërmendur i vendosur nga autoriteti kontraktor nuk është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, ndaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për heqjen e kriterit teknik të përcaktuar në pikën 2.3.10 të dokumentave të tenderit Komisioni vlerëson se referuar edhe arsytimit më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e katalogut ose fragmente të katalogut të prodhuesit i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Për rrjedhojë Komisioni e gjen të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me këtë kriter të kërkuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues sa i përket kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.11 të dokumentave të tenderit e më konkretisht kërkesa e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të paraqesë *Deklaratë/Çertifikatë Konfirmimit CE ose Ecolabel ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar për materialet të cilat do të përdoren në shërbimet e mirëmbajtjes të parashikuara sipas preventivit të publikuar, për të cilët janë kërkuar standarte*

teknike kombëtare apo ndërkombëtare të miratuara, të specifikuara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike (publikuar në SPE), me qëllim vërtetimin e përmbushjes standarteve teknike të kërkuara, Komisioni konstaton se objekti i kontratës ka të bëjë me mirëmbajtjen e objekteve specifike sikurse janë objektet shkollore. Materialet që përdoren në këtë rast ndikojnë në siguri, higjienë, shëndet, mjedis apo cilësi afatgjatë, si p.sh. bojëra, solucione kimike, pastrues, materiale ndërtimi etj. Në dokumentet e tenderit në Shtojca 6 , Formulari i Specifikimeve Teknikej, anë përcaktuar qartë standarde teknike që produktet/materialet duhet të përmbushin. Autoriteti kontraktor në kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.11 të dokumentave të tenderit ka lënë të hapur paraqitjen e Deklaratë/Çertifikatë Konformiteti CE, Ecolabel ose raporte testimi nga ente të akredituar për materialet që do të përdoren në shërbimet e mirëmbajtjes duke mos e detyruar OE për paraqitjen e vetëm me një lloj dokumenti apo ent të veçantë. Sa më sipër Komisioni gjykon se, për sa kohë kriteri i sipërpërmendur është mbështetur në specifikime teknike të qarta dhe të publikuara, ka të bëjë me produkte që ndikojnë në cilësinë e shërbimit, dhe nuk kufizon pjesëmarrjen në mënyrë të panevojshme, përmes alternativave si CE / Ecolabel / raport testimi, nuk është diskriminues, ai është në propocion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu Komisioni sjell në vëmendje faktin se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim si dhe specifikimeve teknike është në diskrecionin e autoritetit kontraktor, por të gjitha këto kërkesa duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, bazuar kjo në nenin 77 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve për kualifikim duhet të garantojë respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, për realizimin me sukses të kontratës dhe me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të nenit 2 të LPP-së.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoriteti kontraktor më sipër, përcaktuar në pikën 2.3.11 të dokumentave të tenderit, është në propocion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë nuk qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK për kriterin 2.3.14 të dokumenteve të tenderit, për të cilin pretendon: *Kriteri 2.3.14, germa “b” ë ku kerkohet “Ne rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore te blerjes dhe kur ato jane te marra me qera te paraqitet kontrata e qirase ku te specifikohet objekti i kontrates dhe afati i saj si edhe dokumentat qe vertetojne pronesine e qiradhenenesit si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore te blerjes, si dhe per per pajisjet rripa sigurimi, platforme ngritese teleskopike mbi 25m, platforme ngritese teleskopike mbi 15m, platforme ngritese gershere mbi 15m, duhet te paraqesin certificate te vlefshme inspektimi te leshuar nga nje organ i akredituar/licensuar. Kerkohet te disponohen Platforme ngritese*

teleskopike mbi 15 m, Platforme ngritese me sistem gershere mbi 15 m, Certificate inspektimi e vlefshme nga organ i licencuar/akredituar. Ne asnje pjese te DST-se nuk percaktohet qe objektet do te lyhen jane ne lartesi mbi 15 m. Per me teper, shumica e shkollave apo kopshteve jane 1n3 kate, qe do te thote 3n10 m lartesi. Nuk ka as plan punimesh, as liste objektesh, as preventiv qe te justifikojte kete kerkese. Kerkesa per platforma ngritese teleskopike apo gershere mbi 15m eshte e tepruar dhe pa lidhje me nevojten reale (duke pasur parasysh edhe faktin qe jane kerkuar edhe platforma ngritese teleskopike mbi 15 metra). Kerkesa per certificate inspektimi te vlefshme eshte e paarsyeshme ne kete rast, per shkak te mungeses se nevojtes, duke e bere nje barre te panevojshme ekonomike dhe pengese per konkurencen.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.14 , të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.14 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç për transportimin e skelave	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Kamion 3.5 - 7.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Platformë ngritëse teleskopike mbi 25 m	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Platformë ngritëse teleskopike mbi 15 m	1 copë	Pronësi ose me qira
5	Platformë ngritëse gërrshëre mbi 15 m	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Skeleri metalike	3000 m ²	Pronësi ose me qira
7	Karroçë dore	5 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	120 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	120 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme	5 copë	Pronësi ose me qira

4	<i>Tabela Sigurimi Teknik</i>	20 copë	<i>Pronësi ose me qira</i>
5	<i>Kuti e Ndhmës së shpejtë</i>	5 copë	<i>Pronësi ose me qira</i>
6	<i>Rripa sigurimi</i>	10 copë	<i>Pronësi ose me qira</i>

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- b) *Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes, si dhe për për pajisjet rripa sigurimi, platformë ngritëse teleskopike mbi 25m, platformë ngritëse teleskopike mbi 15m, platformë ngritëse gërrshëre mbi 15m, **duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme inspektimi të lëshuar nga një organ i akredituar/licensuar.***
- c) *Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Shtojcës 10.*

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.6.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprjnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.6.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike,

si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.6.5. Ndërsa në nenin 41 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.6.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për *Platformë ngritëse teleskopike mbi 15 m; Platformë ngritëse gërshërë mbi 15 m, për të cilat operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme inspektimi të lëshuar nga një organ i akredituar/licencuar*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë dy lloje platformash ngritëse 15 m: Platformë ngritëse teleskopike mbi 15 m, dhe Platformë ngritëse me sistem gërshërë mbi 15 m. Megjithatë, duke qenë se objekt kontrate është shërbimi i mirëmbajtjes, i cili mund të përfshijë ndërhyrje në fasada, tarraca, çati, dritare në lartësi, etj., përdorimi i një platforme ngritëse është i arsyeshëm dhe i justifikueshëm për të garantuar sigurinë në punë dhe aksesin teknik në zona të vështira. Për rrjedhojë, Komisioni gjykon se kërkesa për një platformë teleskopike mbi 15 m vlerësohet si e nevojshme dhe në funksion të realizimit të kontratës, ndërsa kërkesa për platformë të dytë (gërshërë mbi 15 m)

konsiderohet e tepërt dhe jo proporcionale, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka dhënë as informacion lidhur me objektet që do të mirëmbahen. Sa më sipër arsyetuar Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa të modifikojë kriterin e sipërpërpërmendur duke hequr kërkesën për platformë ngritëse gërrshë mbi 15 m në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për heqjen e certifikatës së inspektimit për platformën ngritëse të lëshuar nga organ i licencuar ose i akredituar, si një kërkesë e pajustificuar, Komisioni vlerëson se kjo kërkesë është e justifikuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore për sigurinë në punë. Kjo kërkesë është proporcionale dhe nuk përbën pengesë të pajustificuar, pasi është një kërkesë për të garantuar sigurinë në vendin e punës, dhe lidhet drejt për drejt me natyrën e shërbimit. Është një kërkesë që lidhet me sigurinë e jetës së njerëzve dhe me përgjegjësinë që mban OE si punëdhënëse.

Komisioni vlerëson se kriteri i sipërpërmendur i vendosura nga autoriteti kontraktor është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi referuar natyrës dhe objektit të kontratës një platformë ngritëse e certifikuar vlerësohet e nevojshme duke marrë parasysh terrenin ku kryhet shërbimet/punimet.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *“Pastrime Silvio”* SHPK, për procedurën e prokurimit *“E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-48784-05-23-2025, me objekt: *“Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”*, me fond limit 54,161,860.31 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.06.2025, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*Pastrime Silvio*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

